



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 1. 06. 2010, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar në largim, Fatmir Rexhepi - kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Raif Elezi – zëvendësministër i MAPL, Elita Vokshi – OSBE, Xhemajl Ahmeti - OHCHR dhe Syle Ahmeti - Kosova Sot.

Ftesës nuk iu ka përgjigjur z. Bajrush Xhemajli, sepse ishte në udhëtim zyrtar.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Visar Krasniqi.

Ismet Beqiri – I shprehu mirëseardhje z. Fatmir Rexhepi për emërimin kryetar i Komisionit. Shkurtimisht e njoftoi për fushvëprimtarinë dhe për përbërjen e Komisionit. E shprehu dëshirën ta drejtonte mbledhjen, të cilën e udhëhoqi pasi konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e saj.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i d i t ë s

1. Miratimi i rendi të ditës ,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 26. 05. 2010,
3. Takim pune me z. Raif Elezi, zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me shqyrtimin e pikës 30 të Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropian për vitin 2010,
4. Të ndryshme.

1 . Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2 . Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 26. 05. 2010

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26. 5. 2010.

3 . Takim pune me z. Raif Elezi, zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me shqyrtimin e pikës 30 të Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropian për vitin 2010

Ismet Beqiri – Në këtë mbledhje ishte i ftuar z. Bajrush Xhemajli, kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosoves, por për shkaqe objektive nuk iu ka përgjigjur ftesës. Prandaj lidhur me këtë pikë hap debatin.

Raif Elezi – Misioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është avancimi i qeverisjes lokale në bashkëpunim me institucionet relevante, që konsiston në sigurimin e shërbimeve efikase dhe pa diskriminim në nivelin komunal dhe sa më afër qytetarëve. Divizioni për të Drejtat e Njeriut në MAPL, në vazhden e veprimeve të përbashkëta me organet komunale, që ndërlidhen me avancimin dhe me promovimin e të drejtave të njeriut në nivelin lokal, e ka iniciuar krijimin e njësive për të drejtat e njeriut në komuna. Ekzistimi i këtyre njësive u përgjigjet nevojave për zbatimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit që miratohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që e kanë për qëllim promovimin, mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave themelore të njeriut. Themelimit të këtyre njësive u ka paraprirë “Programi përkrahës për zhvillimin e njësive komunale për të drejtat e njeriut”. Mund të përfundojmë se NJDNJK-të janë funksionale, mirëpo kërkohet që për realizimin e aktiviteteve në kontekst të përmbushjes së përgjegjësisë të veta, si promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, të kenë linjë të veçantë buxhetore.

Luljeta Shehu - Pas takimit, që e kam zhvilluar në Kuvendin Komunal të Prizrenit me koordinatorin për të drejtat e njeriut, në të cilin kërkesa e tyre ishte që për zyrtarët, që janë duke punuar në këto zyra, do të duhej të jepej një buxhet që të paguhet nga buxheti i Ministrisë. Këta zyrtarë kanë mjaft aktivitete, por nuk kanë buxhet. Ju zëvendësministër, a mund të na njoftoni më shumë rreth kësaj çështjeje?

Ibrahim Makolli - Në çfarë formash këto njësi i avancojnë të drejtat e njeriut dhe cili është fushëveprimi i tyre? Cilat janë aktivitetet e tyre në avancimin e të drejtave të njeriut? Sqaroi se këto njësi do të duhej ta zbatonin strategjinë për të drejtat e njeriut.

Drita Maliqi - A është shkelur Ligji për barazi gjinore? Në nivelet komunale në bazë të Ligjit duhet të jenë zyrat për barazi gjinore, jo për ata që kohëve të fundit i keni konvertuar në zyrarë për të drejtat e njeriut.

Danush Ademi - Ministria e Pushtetit Lokal a ka nxjerrë udhëzim administrativ, në të cilin thuhet se zëvendëskryesues nga radhët e komuniteteve mund të ketë, por pa pagë? Theksoi se në çdo komunë ka filluar të bëhet reduktimi i punëtoreve në zyrat për komunitete. Komisioni lidhur me këtë pikë lejoi debat të gjerë, konstruktiv dhe njëzëri e nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Komisioni në mbledhjen e radhës do ta analizojë rezultatin e takimit dhe do t'i nxjerrë konkluzionet përkatëse, me të cilat do ta njoftojë Komisionin Parlamentar për Integritet rreth pikës 30 të Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për integritet evropian për vitin 2010.

4. Të ndryshme

Ismet Beqiri – I kërkoi Nerxhivane Dautit, që ne cilësi të raportueses, ta merrte fjalën që ta njoftonte Komisioni me përmbajtjen e kërkesës së Burim e Arsim Ramadanit dhe të Arben e Jeton Kiçinës. Shtoi se Këshilli Organizativ i Protestës “Drejtësi për çlirimtarët”, për Burim e Arsim Ramadanin dhe Arben e Jeton Kiçinën, të akuzuar për rastin “Hajra”, kërkon nga EULX-i dhe nga institucionet vendore gjykim të drejtë e të paanshëm.

Për këtë material janë njoftuar institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës dhe ato ndërkombëtare: kryetari i Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Avokati i Popullit, shefi i EULEX-it, përfaqësuesi ndërkombëtar civil, Ministria Drejtësisë, Gjykata Supreme e Kosove, Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe kryeprokurori i EULEX-it - të gjithë mekanizmat që merren me këtë çështje. Me seriozitet dhe me kompetencë profesionale konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e Komisionit. U rekomandon ankuesve t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Ibrahim Selmanaj - Peticioni dallon nga të tjerët dhe duhet të shqyrtohet me një seriozitet më të madh. Nëse është nënshkruar, ashtu siç parashihet me ligj, do të duhej të radhitej pikë e veçantë në një nga seancat e radhës së Kuvendit.

Ibrahim Makolli - Ishte i mendimit se kjo çështje nuk ishte e fushëveprimin të Komisionit. Prandaj i vetmi autoritet kompetent për të është Gjykata Kushtetuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri